

P. nr. 80/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Bute Ramosaj , në çështjen penale kundër të akuzuarit I. S. nga fsh. G. , K-Gjakovë , për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.1685/17 të dt.25.01.2018,në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë **30.08.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, perf.i autorizuar i te dëmtuarës L. M. si dhe të akuzuarit I. S., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. S.** ,nga fshati G. K- Gjakove, nga i ati U., dhe nënës A., e gjinisë M., data e lindjes ..., ka te kryer shkollën fillore, i pa pune, i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar at i 3 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r

Për shkak se :

-me dt. të pa vërtetuar e gjerë me dt. 08.06.2017, në lokalitetin e tij i cili gjendet ne Fshatin G.ë K Gjakovë ,me qëllim që veti ti sjelli përfitim pasuror te kundërligjshëm , me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë qe jashtë njehsorit elektrik me nr, përmes kabllor 4x6 mm ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar , gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë, me rastin e kontrollës ,me ç’ rast të dëmtuarës K. –Divizioni i Rrjetit – Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumë prej 2.418.72 Euro.

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,7,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73 ,neni 320 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit ia shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **3(tre) muajve** dhe dënim me gjobë ne **shumë prej 200.00 (dyqind) euro**, të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1685/17 të dt.25.01.2018,e ka akuzuar të akuzuarin I. S. nga Gjakova , për shkak të veprës penale për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu lexon aktakuzën PP.nr. 1685/17 të dt.25.01.2018,me ç' rast prokurori deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari I. S. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjendje e tillë është konstatuar nga punëtorët e K.-it ne njehsorin te cilën e shfrytëzoje , pas njoftimit nga Prokuroria në shkresat e lëndës menjëherë me datë 20.04.2018, kam bërë kompensimin e demit në emër të rikthimit të humbjeve të dëmtuarës për çka edhe e prezantojë dëftesën e pagesës. Me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer , premtoi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem i kujdesshëm andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysht rrethanat lehtësuese , si dhe pranimi i fajësisë , premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla ,si dhe është hera e parë qe kam rëndesh me ligjin dhe të më shqiptojë një dënim më të butë.

Përf. i autorizuar i te dëmtuarës L. M., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale , dhe nuk kërkoi kompensim dëmi , duke parë se nga transaksionet e konsumatorit dhe ekstrakt nga libri afarist , këtu është i akuzuari ka bërë rikthimin e dëmit në faturën me numër ..., dhe atë në vlerën prej 2.418.72, si dhe rrjedhojë nuk e paraqesin kërkesën pasurore juridike .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari I. S. : **-me dt. të pa vërtetuar e gjerë me dt. 08.06.2017,** në lokalit të tij i cili gjendet ne Fshatin G.ë K Gjakovë ,me qellim qe vetit ti sjelli përfitim pasuror te kundërligjshëm , me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike ne atë mënyrë qe jashtë njehsorit elektrik me nr përmes kabllor 4x6 mm ka bërë lidhjen direkt në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar , gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë me rastin e kontrollës ,me ç' rast të dëmtuarës K. –Divizioni i Rrjetit – Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumë prej 2.418.72 Euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjykata ka pasur parasysht të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa

si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është baba i 3 fëmijëve , është mbajtës i vetëm i familjes, i gjendjes se dobët ekonomike, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim ,pendimin e tij dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej veprat e tilla ,rikthimi i humbjeve të dëmtuarës në tërësi me dt. 20.04.2018 si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjkata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 75 të KPRK-së Gjkata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg ne kohëzgjatje prej 3(tre) muajve dhe dënim me gjobë prej 200.00 (dyqind) euro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1(një) viti te mos kryej ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr. 80/18 më datë 04.09.2018**

**Sekretarja juridike
Bute Ramosaj**

**Gjyqtarja
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.